



KUSHTET E PËRGJITHSHME TË ABONIMIT NË SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT ME FATURIM MUJORË PËR BIZNESE TË OFRUARA NGA IPKO TELECOMMUNICATIONS SH.P.K

Neni 1 - Përmbajtja e Kushteve të Përgjithshme të Abonimit

1.1 Kushtet e Përgjithshme të Abonimit në Shërbimet e Telekomunikimit me Faturim Mujor këtu e tutje referuar si ("**Kushtet e Përgjithshme të Abonimit**") për Biznese (këtu e tutje referuar si "**Përdoruesi**"), të ofruara nga IPKO Telecommunications SH.P.K. (këtu e tutje referuar si "**IPKO**"), përmbajnë të dhënat e përgjithshme, mbi kushtet e abonimit në shërbimet e ofruara nga IPKO për Përdorues

1.2 Kushtet e Përgjithshme të Abonimit, janë të aplikueshme për të gjithë personat juridik, të cilët, kanë nënshkruar Kontratë Abonimi për njërin apo më shumë nga shërbimet që ofrohen nga IPKO dhe këto Kushte të Përgjithshme të Abonimit, së bashku me Kushtet e Veçanta të Abonimit si dhe shtojcat e tjera të Kontratës, konsiderohen pjesë integrale të së njëjtës.

1.3 Përveç këtyre Kushteve, mënyra dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve me faturim mujor të telekomunikimit për përdorues nga IPKO, do të udhëhiqen gjithashtu nga Ligji për Komunikimet Elektronike Nr. 04/L-109, nga rregulloret e aplikueshme për ofrimin e shërbimit të telekomunikimeve elektronike, në Kosovë të miratuara nga Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Kosovë (në tekstin e mëtejme referuar si "ARKEP"); nga Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, e miratuar nga Komisioni i Pavarur për Media (në tekstin e mëtejme referuar si "KPM"); si dhe nga Kontrata e Abonimit, nga Kushtet e Veçanta për abonim në shërbimet me faturim mujor të telekomunikimit, nga oferta, shtojcat përkatëse, çmimet e publikuara të IPKO's, si edhe dokumentet e tjera të nënshkruara nga Përdoruesi dhe IPKO, të cilat, në tërësi, përbëjnë Marrëveshjen.

Neni 2. Definicionet

"**Marrëveshja**" do të thotë e tërë marrëdhënia kontraktuale midis Përdoruesit dhe IPKO's për shfrytëzimin e shërbimit të përzgjedhur nga ana e Përdoruesit, e cila përbëhet nga Kontrata për Abonim e nënshkruar mes Përdoruesit dhe IPKO's, Shtojcat përkatëse, këto Kushte të Përgjithshme Abonimit, Kushtet e Veçanta të Abonimit, lista e publikuar e çmimeve të IPKO's dhe dokumentet tjera përcjellëse.

"**Kontrata**" është dokumenti i cili nënshkruhet nga palët dhe përmban elementet thelbësore të detyrueshme për të cilat janë pajtuar palët.

"**Data e hyrjes në fuqi**" është data/koha në të cilën Kontrata është nënshkruar.

"**Aktivizimi/Data e lëshimit të shërbimit**" është koha nga e cila Përdoruesi ka qasje dhe mund të përdor shërbimin dhe/apo produktin e përzgjedhur.

"**Pezullim**" është gjendja në të cilën Përdoruesi nuk ka qasje në shërbime përkohësisht, ndërsa shërbimi nuk është anuluar ende.

"**Anulimi/Terminimi**" është gjendja në të cilën të gjitha shërbimet në të cilat Përdoruesi ka pasur qasje janë anuluar dhe nuk mund të përdoren pa ri – abonim.

"**Përdoruesi Shërbimeve**" është personi fizik i cili është i abonuar në një apo më shumë produkte dhe shërbime të ofruara nga IPKO, dhe i cili në mënyrë direkte, pranon Kushtet e Përdorimit të IPKO's.

"**Rrjeti**" është hapësira ku lidhen pajisjet, pa ose me tel, që bëjnë të mundur ofrimin e shërbimeve të telekomunikimit.

"**Pajisjet**" janë instrumente të nevojshme për ndërmarrjen ose kryerjen e shërbimit. Ato mundësojnë kryerjen e detyrave me anë të përparësive mekanike, ose ofron mundësinë që nuk do të ishte e mundshme t'i ofrohej në mënyrë natyrore Përdoruesit të shërbimit.

"**Modemi**" – është pajisje që mundëson lidhjen e kompjuterëve me rrjetin e IPKO's dhe nga aty e drejton lidhjen në internet.

"**Kartela Smart (Smart Card)**" është Kartelë që futet në marrësin digjital dhe pa të cilën nuk mund të hapen paketat me kanale televizive.

"**Moduli**" është një pajisje e cila e zëvendëson marrësin digjital dhe kartelën "smart" si një pajisje e vetme duke përcjurar sinjalin digjital i cili pastaj paraqitet në televizor.

"**Shërbimet**" janë produktet e ofruara të cilat përmbajnë shërbimet e internetit, të televizionit digjital dhe shërbimet e telefonisë fikse për Përdoruesit me parapagim dhe/apo me faturim mujor.

"**Shërbimi TVIM**" është shërbim me vlerë të shtuar i ofruar për Përdoruesin e shërbimit të televizionit digjital që mundëson casjen në aplikacionin për telefon mobil, tablet ose laptop për të shikuar kanale të caktuara të IPKO's, në po të njëjtat pajisje.

"**Shpejtësia minimale**" (Shpejtësia e garantuar) – është shpejtësia më e ulët, të cilën e ofron ofruesi i qasjes në internet për përdoruesin në përputhje me kontratën.

"**Shpejtësia maksimale**" – është shpejtësia që përdoruesi pret të pranojë së paku një pjesë të kohës (p.sh. së paku një herë në ditë).

"**Shpejtësia e reklamuar**" – është shpejtësia që një ofrues i shërbimit të qasjes në internet e përdor në komunikimet komerciale, përfshirë reklamimet dhe marketingun lidhur me promovimin e ofertave të qasjes në internet. Në rast se shpejtësitë janë të përfshira në një ofertë marketingu të ofruesit të qasjes në internet, shpejtësia e reklamuar duhet të specifikohet në informacionin e publikuar dhe në kontratë për secilën ofertë.

"**Shpejtësia e zakonshme në dispozicion**" është shpejtësia ku një përdoruesi mund të arrij shumicën e kohës gjatë qasjes në shërbime.

Neni 3 Obligimet e IPKO's

Qasja në shërbimin e ofruar dhe cilësia e shërbimit

3.1 Për qëllime të nënshkrimit të Kontratës për Abonim dhe dokumenteve përcjellëse, me qëllim të abonimit në shërbimet e telekomunikimit të ofruara nga IPKO për Biznese, Përdoruesi duhet të paraqesë në IPKO dokumentet e dokumentet në vijim: Certifikatën e biznesit; Informacion mbi Biznesin, me afat vlefshmërie prej më së paku 12 muaj; Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar për të lidhur Marrëveshjen; Në rast se personi i autorizuar nuk është pronari i biznesit, autorizimin original për të njëjtin.

3.2 Qasja në shërbim, ndër të tjera, mundësohet nga pajisjet që mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi, të cilat, përbëhen nga modemi, marrësi digjital, moduli dhe kartela smart. Të njëjtat, janë dhe mbeten pronë e IPKO's, ndërsa Përdoruesit i jepen në shfrytëzim gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes. Me rastin e ndërprerjes së marrëveshjes, Përdoruesi është i obliguar që të kthejë të gjitha pajisjet që ka në shfrytëzim, jo më larg se pesë (5) ditë.

3.3 Shpejtësia minimale, shpejtësia e zakonshme ne dispozicion si dhe shpejtësia maksimale e ngarkimit dhe shkarkimit varësisht nga kapaciteti/pako qe Përdoruesi ka ne shfrytëzim, do te variojne si në vijim:

3.3.1 Tabela më poshtë paraqet shpejtësinë e internetit për pakot për biznese me shërbime të kombinuara

PAKO POSTPAID	Shpejtësia e Shkarkimit			Shpejtësia e Ngarkimit		
	Max	Min (20%)	Usual (20%)	Max	Min (20%)	Usual (20%)
PRO ELITE	300 Mbps	60 Mbps	60 Mbps	50 Mbps	10 Mbps	10 Mbps
PRO ULTRA HD	250 Mbps	50 Mbps	50 Mbps	50 Mbps	10 Mbps	10 Mbps
PRO ULTRA						
TOP XL	200 Mbps	40 Mbps	40 Mbps	50 Mbps	10 Mbps	10 Mbps
PRO EXTRA HD	150 Mbps	30 Mbps	30 Mbps	50 Mbps	10 Mbps	10 Mbps
TOP L	100 Mbps	20 Mbps	20 Mbps	40 Mbps	8 Mbps	8 Mbps
PREMIUMHD SUPERDUO BIZ	100 Mbps	20 Mbps	20 Mbps	40 Mbps	8 Mbps	8 Mbps
PRO EXTRA						
PRO START						
PRO BASIC						
SUPERDUO HD FAMILY BIZ	80 Mbps	16 Mbps	16 Mbps	16 Mbps	3.2 Mbps	3.2 Mbps
TOP M	60 Mbps	12 Mbps	12 Mbps	12 Mbps	2.4 Mbps	2.4 Mbps
SUPER DUO PREMIUM HD BIZ 10+2	50 Mbps	10 Mbps	10 Mbps	10 Mbps	2 Mbps	2 Mbps
SUPER DUO FAMILY HD BIZ 10+2	40 Mbps	8 Mbps	8 Mbps	8 Mbps	1.6 Mbps	1.6 Mbps
TOP S	20 Mbps	4 Mbps	4 Mbps	4 Mbps	0.8 Mbps	0.8 Mbps

3.4 Pranimi i shpejtësive të përshkuara më lartë, varet nga shume faktorë, përkatësisht se sa pajisje janë të lidhura në pajisjen fundore të IPKO's, lokacioni i Përdoruesit, aplikacionet e ngarkuara në pajisjen e Përdoruesit si dhe konfigurimi i tyre, trafik i rënduar në një lokacion etj. Rrjedhimisht, shpejtësitë e përshkuara nga larte do te sigurohen deri tek pajisja e IPKO', dhe IPKO nuk mund te kontrolloj pajisjet e Përdoruesit te cilat i njëjti i përdor për të marr shërbimin.

3.5 Për shërbimin e Internetit orët e pikut (peak hours) janë duke filluar nga ora 20:00 dhe zgjasin deri ne orën 00:00.

3.6 Duke njoftuar paraprakisht Përdoruesin, IPKO rezervon të drejtën të ndërpresë ofrimin e shërbimit për arsye të mirëmbajtjes, avancimit, modernizimit, apo optimizimit të rrjetit. Këto ndërprerje mund të zgjasin për aq kohë sa do të zgjasë kryerja e punëve.

3.7 IPKO do të ndërmarr masa të arsyeshme të menaxhimit të trafikut, ne mënyrë që parandaloj bllokimin apo sigurinë e rrjetit, masa të tilla do të jenë proporcionale dhe do të zgjasin për aq sa është nevojshme/domosdoshme.

3.8 IPKO do te bëjë riparimin e pengesave duke u referuar në kushtet dhe nivelin e shërbimeve te raportuara nga matjet e bëra nga ARKEP, duke mos i përjashtuar edhe shërbimet e asistencës;

3.9 Në pajtim me këto Kushte, IPKO nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë ndërprerje, ose dobësim të shërbimit shërbimet e Televizionit Digjital dhe Internetit për përdorues e biznesit me faturim mujor kontratë postapid, apo për ndonjë defekt në rrjet, i shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, apo nga ndonjë rrethanë jashtë kontrollit të IPKO's, të cilën nuk mund ta parashikojë dhe parandalojë (forca madhore). Ne rast te defekteve te mëdha ne rrjete, IPKO do t'i ndërmarrë te gjitha hapat e mundshëm për riparim sa më të shpejt të këtyre defekteve, duke e respektuar listën prioritare të nenit 16.1 te Rregullores Nr. Prot. 009/B/16 të ARKEP.

3.10 IPKO është përgjegjës për ofrimin e shërbimeve në përputhje me këto Kushte, në lokacionin e përcaktuar në Kontratën e nënshkruar mes IPKO's dhe Përdoruesit. Në rast të ndryshimit të lokacionit, IPKO mbanë përgjegjësi për transferim të shërbimeve vetëm në zonat ku ka mbulueshmëri për ofrimin e shërbimeve të IPKO's, ndërsa nëse zona përkatëse nuk ka mbulueshmëri të tillë, IPKO nuk mbanë asnjë përgjegjësi për transferimin e shërbimeve përkatëse. Përdoruesi në secilin rast, obligohet që të kompensoje IPKO'n me pagesën mujore të muajit aktual si dhe pagesën mujore të shërbimit për periudhën e mbetur në përputhje me kushtet e Kontratës dhe dispozitat e përcaktuara ne nenin 9 te këtyre kushteve.

3.11 Asnjë siguri, apo garanci nuk mund të jepet lidhur me disponueshmërinë, cilësinë, funksionimin, apo mirëmbajtjen e trafikut të zërit, apo të të dhënave në rastet kur Përdoruesi komunikon me individë që përdorin një operator tjetër telekomunikues.

Neni 4 – Obligimet e Përdoruesit

4.1 Përdoruesi është i obliguar të përdorë shërbimet e telekomunikimit për biznese, në pajtim të plotë më marrëveshjen në fjalë, kushtet e veçanta tw përdorimit si dhe kushtet e përgjithshme të përdorimit. Përdoruesi nuk lejohet të përdor ose lejoj përdorimin e Shërbimeve për ndonjë qëllim të ndaluar, të pahijshëm, të paligjshëm, të dëmshëm, të paautorizuar, diskreditues ose mashtrues ose të shkaktoj ndonjë lëndim, ofendim ose ngacim të ndonjë personi ose të dërgoj mesazhe të padëshirueshme komerciale ndonjë personi.

4.2 Përdoruesit i ndalohet keqpërdorimi i shërbimit, gjegjësisht, Përdoruesi është i obliguar të përdor shërbimet në përputhje me Marrëveshjen dhe ligjet në fuqi, përndryshe IPKO ka të drejtë të bashkëpunoj me organet kompetente të ligjit dhe, varësisht nga shkalla e keqpërdorimit IPKO ka të drejtë të marrë këto masa:

- i. T'ia tërheqë vërejtjen Përdoruesit që të shfrytëzojë shërbimin në pajtueshmëri me Marrëveshjen;
- ii. Të pezulloj apo anulojë automatikisht shërbimin e dhënë nga IPKO, pa kurrfarë përgjegjësie për kompensim ndaj Përdoruesit dhe si rezultat të kërkojë kompensim dëmshëm të pësuar nga keqpërdorimi, bërë nga Përdoruesi.

4.3 Përdoruesi nuk lejohet të përdor ose lejoj përdorimin e Shërbimeve, që do të shkaktojnë mosfunksionimin e rregullt të rrjetit ose kualitetin e Shërbimeve, dobësimin apo ndërprerjen apo ndërhyrjen në integritetin ose sigurinë e cilido rrjet apo sistem të telekomunikimit.

4.4 Përdoruesi nuk lejohet të rishes asnjë produkt ose shërbim të dhënë nga IPKO përveç në raste kur ka pajtim me shkrim me marrëveshje të ndarë me

IPKO' n. Përdorimi i produkteve dhe shërbimeve të IPKO's është qartazi i limituar për Përdoruesin, emri i të cilit paraqitet në Kontratë. Përfitimet, të drejtat dhe obligimet të pranuar me këtë marrëveshje nga Përdoruesi nuk mund të transferohen tek pala e tretë pa miratim me shkrim nga IPKO.

4.5 Përdoruesi është i obliguar të paguaj të gjitha pagesat dhe detyrimet në përputhje me Marrëveshjen.

4.6 Përdoruesi duhet menjëherë të lajmëroj IPKO' n në lidhje me problemet eventuale me shërbimet ose produktet që është duke i përdorur.

4.7 Përdoruesi duhet të ofroj shënimet personale të sakta kur ato kërkohen nga IPKO. Për çdo ndryshim të këtyre informacioneve Përdoruesi duhet ta njoftoj IPKO-n brenda dhjetë (10) ditëve nga dita e ndryshimit.

Neni 5 – Pajisjet e IPKO's dhe facilitetet e rrjetes:

5.1 Pajisjet për ofrimin e shërbimit të Internetit:

5.1.1 Modemi është pronë e IPKO's dhe Përdoruesit i jepet në shfrytëzim gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes.

5.1.2 Përdoruesi është përgjegjës për sigurinë e kompjuterit të tij, harduerit dhe softuerit apo pajisje të tjera në përdorim, duke përfshirë dhe të dhënat e tij. IPKO nuk mirëmban kompjuterin dhe LAN –in e Përdoruesit dhe nuk mban kurrfarë përgjegjësie për dëmtimin, apo humbjen e këtyre të dhënave, si rezultat i përdorimit të shërbimit

5.2 Pajisjet për ofrimin e shërbimit të Televizionit Digjital HD:

5.2.1 Marrësi digjital dhe Kartela Smart janë pronë e IPKO's dhe Përdoruesit i jepen në shfrytëzim gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes.

5.3 Pajisjet për ofrimin e shërbimit të Telefonisë Fikse:

5.3.1 Për të përdorur shërbimin e Telefonisë Fikse, Përdoruesi do të pajiset me Voice Modem, i cili mundëson qasjen e Përdoruesit në këtë shërbim.

5.3.2 Voice modemi është pronë e IPKO's në gjatë gjithë kohës dhe Përdoruesit i ipet në shfrytëzim, gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes.

5.4 Mirëmbajtja e pajisjeve

5.4.1 Përdoruesi është i obliguar që të përdorë dhe mirëmbajë pajisjet sipas udhëzimeve të prodhuesit të tij, si edhe atyre të dhëna nga IPKO. IPKO nuk mban përgjegjësi për prishjen e pajisjeve si rezultat i pakujdesisë, apo mosdijes së Përdoruesit.

5.4.2 Në rast se Përdoruesi nuk u përmbahet rregullave për përdorimin e pajisjeve dhe si rezultat i veprimeve të tij-saj modemi është i papërdorshëm, atëherë Përdoruesi duhet të paguajë për përdorimin e modemit të ri, çmimi i të cilit është i përcaktuar në listën e çmimeve të IPKO's.

5.4.3 Përdoruesi është përgjegjës për çdo dhe të gjithë rrjetin elektrik të furnizimit me energji të lidhur me pajisjet që ofron shërbimin. Përdoruesi nuk do ta bëjë IPKO' n përgjegjës për çdo dhe të gjitha defektet dhe / ose dëmet që rezultojnë nga energjia elektrike me të cilën është e lidhur pajisja e shërbimit.

5.4.4 Përtokëzimi dhe masat mbrojtëse ndaj rrufesë dhe mbitensionit elektrik të pajisjeve dhe instalimeve shtëpiake të klientit (përveç marrësit digjital dhe modemit), janë pjesë e instalimeve dhe pajisjeve shtëpiake të përdoruesit dhe për këto, IPKO Telecommunications sh.p.k. nuk mban asnjë përgjegjësi në të gjitha rastet kur ato pajisje dhe instalime nuk janë ekzekutuar/vendosur dhe kyçur sipas normave dhe standardeve rajonale. Të gjitha dëmet eventuale të pajisjeve ose instalimeve të përdoruesit, që mund të shkaktohen ose shkaktohen nga jo korrektesia e këtyre masave mbrojtëse ose mosrespektimi i standardeve dhe normave rajonale, nuk do të kompensohet nga IPKO Telecommunications sh.p.k. Për sigurinë e përdoruesit dhe të pajisjeve shtëpiake të përdoruesit, rekomandohet që përdoruesi të bëjë për tokëzimin në një pikë të përbashkët të gjitha video dhe audio pajisjeve dhe instalimeve të kyçura në rrjetin kabllor të IPKO Telecommunications sh.p.k.

5.4.5 Lista e aktiviteteve parandaluese e propozuar nga IPKO për përdoruesin e saj është si vijon:

5.4.5.1 Në kohë të rrufesë përdoruesin duhet të shkyç pajisjet nga priza elektrike;

5.4.5.2 Përdoruesi duhet të sigurojë që o tërë rrjeti elektrik në shtëpi ka sistem tokëzimi me standard prej <50hm;

5.4.5.3 Përdoruesi këshillohet të përdorë/instalojë priza me mbrojtje nga tensioni në mënyrë që të mbrojë amvisërinë nga rrufetë dhe tensioni i lartë elektrik;

5.4.5.4 Përdoruesi këshillohet të përdorë korrektor të tensionit dhe UPS (furnizim i pandërprerë me rrymë) për të mbrojtur amvisërinë nga tensioni i paqëndrueshëm dhe ndërprerjet e rrymës elektrike;

5.4.5.5 Udhëzime për kyçjen e drejtë të pajisjeve të IPKO's

a) Marrësi digjital: Hapi 1: Shkyç TV; Hapi 2: Lidh kabllon RF (lidhësi i radio frekuencës) në IPKO STB; Hapi 3: Lidh kabllot e TV (HDMI – Multimedia Interfejs me Definim të lartë ose RCA fono lidhësin); Hapi 4: Kyç STB (Marrësi digjital) në rrymë; Hapi 5: Hap TV dhe STB;

b) Moduli: Hapi 1: 1 Shkyç TV; Hapi 2: Vendos Modulin në TV në mënyrën e duhur tek porti adekuat për modul. Hapi 3: Hap TV dhe verifikoni nëse opsioni i menysë është i dukshëm.

5.4.5.6 Udhëzime për shkyçjen e drejtë të pajisjeve të IPKO's:

a) Marrësi digjital: Hapi 1: Mbyll TV dhe the STB(Marrësi digjital); Hapi 2: Nxjerr kabllon e STB nga rryma; Hapi 3: Nxjerr kabllon IPKO RF (lidhësi i radio frekuencës) nga STB(Marrësi digjital); Hapi 4: Nxjerr kabllon HDMI (HDMI - Multimedia Interfejs me Definim të lartë).

b) Moduli: Hapi 1: Mbyll TV, Hapi 2: Nxjerr modulin nga porti i TV-së.

5.4.6 Në rast të vjedhjes së pajisjes/pajisjeve, Përdoruesi është i obliguar që të sjellë raportin për vjedhjen nga Policia e Kosovës, në mënyrë që të marrë pajisjen e re. Në rast se Përdoruesi nuk mund ta sigurojë këtë raport, atëherë duhet të paguajë për përdorimin e pajisjes së re.

5.4.7 Pajisjet e IPKO-s funksionojnë vetëm kur të njëjtat janë të kyçura në energjinë elektrike, prandaj, nuk mund të bëhet ofrimi i shërbimeve, gjatë mungesës së energjisë elektrike.

5.4.8 Duke i njoftuar paraprakisht Përdoruesit, IPKO ka të drejtë që t'i ndërroj pajisjet/modemin të cilët janë në shfrytëzim të Përdoruesit, me qëllim të mirëmbajtjes, avancimit, modernizimit, apo optimizimit të rrjetit. Pajisjet mbesin në pronësi të IPKO's

5.4.9 Te gjitha pajisjet që përdoren nga përdoruesit duhet t'i përshtaten standardeve dhe specifikave teknike të aprovuara nga ARKEP dhe implementuara nga IPKO.

5.4.10 Për ndryshim të çfarëdo pajisje në shfrytëzim të Përdoruesit, Përdoruesi dhe IPKO do të nënshkruajnë formën për zëvendësim të pajisjes, në bazë të së cilës do të evidentohen pajisjet e reja në shfrytëzim të Përdoruesit.

5.4.11 Shërbimi TVIM është i limituar në rrjetin e IPKO's për shkak të drejtave për transmetim të përmbajtjes së kanaleve që ky shërbim i ofron.

6. E drejta e autorit

6.1 Të gjitha programet e transmetuara në rrjetin kabllor digjital të IPKO's, janë të mbrojtura nga Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat tjera të Përafërta si edhe ligjet e tjera relevante në fuqi në Kosovë. Është rreptësisht e ndaluar shumëzimi, ripublikimi, ruajtja, ritransmetimi, apo rishpërndarja e ndonjë nga programet e transmetuara në Televizionin Digjital Kallor të IPKO's, përveç për përdorim personal e assesi komercial.

6.2 Shërbimi TVIM është i limituar në rrjetin e IPKO's për shkak të drejtave për transmetim të përmbajtjes së kanaleve që ky shërbim i ofron.

7. Mbrojtja e të dhënave, privatësia e përdoruesve të IPKO's, bashkëpunimi me organe të rendit

7.1 Mbrojtja e të dhënave, privatësia e përdoruesve të IPKO's . IPKO në përputhje të plotë me Ligjin për Mbrojtjen e të dhënave personale përpunon te dhënat personale të përdoruesve të shërbimeve të saj të komunikimeve elektronike, që përfshijnë emër, mbiemër, numër personal, adresë, numër telefoni fiks, numër mobil, adresë email. - Përdoruesi mund të informohet lidhur me procedurat e ruajtjes dhe të përpunimit të dhënave personale në faqen zyrtare të IPKO's <https://www.ipko.com/politika-e-privatesise-ipko-telecommunications-llc/> . Përdoruesi gjithashtu mund të paraqes çfarëdo kërkesë apo ankese me shkrim në lidhje me përdorimin e të dhënave, në email adresën dpo@ipko.com.

7.2 Bashkëpunimi me organe të rendit. Përdoruesi mban përgjegjësi të plotë për informacionin, apo përmbajtjen e të dhënave, të cilat i transmeton dhe i bartë te personat e tretë nëpërmjet rrjetit të internetit të IPKO's. IPKO nuk mban kurrfarë përgjegjësie për këtë përmbajtje, si edhe as për të dhënat, të cilat Përdoruesi i pranon nga palët e treta, nëpërmjet rrjetit të IPKO's. Në pajtim me ligjet në fuqi në Kosovë, IPKO do të bashkëpunojë me organe të rendit për kërkesat që këto organe do të kenë lidhur me shërbimin në fjalë që përdor Përdoruesi.

8. Pezullimi dhe anulimi i shërbimeve

8.1 IPKO mundet, me njoftim paraprak, të pezulloj Shërbimet Përdoruesit në tërësi ose pjesërisht në rast se Përdoruesi dështon të kryej detyrimet në afat të çfarëdo shume ndaj IPKO-s me anë të kësaj Marrëveshjeje në datën e caktuar të specifikuar në faturë, ose në rast të kryerjes së ndonjë aktiviteti mashtrues ndaj produkteve dhe shërbimeve të IPKO's.

8.2 IPKO mund, pa njoftim paraprak, të anuloj Shërbimet Përdoruesit për ndonjë arsye të bazuar, duke përfshirë, pa limitim:

i. kur Përdoruesi nuk përmbush obligimet që dalin nga Marrëveshja (dhe veçanërisht Obligimet e Përdoruesit të përcaktuara në këtë dokument) ose ndonjë ligji.

ii. Përdoruesi i ofron IPKO's informata të falsifikuara, të pasakta ose mashtruese ose nuk e njofton IPKO' n për ndonjë ndryshim që ngjan.

8.3 Në rast të anulimit, çfarëdo vlere e mbetur në llogarinë e Përdoruesit do të tërhiqet nga IPKO.

9. Forca Madhore

9.1 Asnjëra palë nuk është e përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së obligimeve të shkaktuara nga ose që rezultojnë nga Forca Madhore që përfshin ngjarjet që janë të paparashikueshme, të papritura, të pa rezistueshme dhe përtej kontrollit të palëve, siç është moti i ashpër dhe ekstrem, përmytje, rrëshqitje dhe, tërmet, stuhi, vetëtimë, zjarr, akte terrorizmi, luftë (me apo pa deklarimin e luftës), pandemi, trazira, eksplodime, grevë ose protesta të punëtorëve, trazira civile, sabotazh, shpronësim nga ana e qeverisë ose akte tjera apo ndonjë ndodhi që është jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës përkatëse. IPKO nuk është përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së obligimeve në rast të:

i. refuzimi apo vonesa nga pala e tretë për furnizimin e IPKO-s me shërbime të telekomunikimit dhe në rast kur nuk ka shërbim alternativ tjetër në dispozicion me çmim të arsyeshëm; ose

ii. IPKO është i penguar nga kufizimet të natyrës ligjore apo të ARKEP të ofroj shërbimin e caktuar.

10. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe/apo emergjencës shëndetësore

10.1 Në secilin rast, të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe/apo emergjencës shëndetësore në vend, IPKO do të ndërmer të gjitha masat për koordinim efektiv për menaxhimin e situatës në përputhje me të gjitha rekomandimet nga institutet përgjegjëse kombëtare, dhe të gjitha Vendimet e organit vendimmarrës.

10.2 IPKO nuk do të mbajë përgjegjësi për dështimin e përmbushjes së obligimeve që rezultojnë si rrjedhojë e kufizimeve të përcaktuara nga Vendimet e organit vendimmarrës në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, emergjencës shëndetësore, fatkeqësive dhe/apo gjendjeve të tjera të shpallura në situata emergjente, të cilat ndikojnë në kufizimin e shfrytëzimit të resurseve të IPKO's.

11. Ligji në fuqi

11.1 Këto Kushte të Përgjithshme Abonimi, do të udhëhiqen dhe interpretohen në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë.

12. Dispozitat përfundimtare

12.1 Këto Kushte të Përgjithshme Abonimi, përbëjnë pjesë të marrëveshjes mes Përdoruesit dhe IPKO's.

12.2 Në rast se ndonjë dispozitë në këto Kushte të Përgjithshme Abonimi, është e paligjshme ose e pa zbatueshme, e njëjta do të largohet ndërsa, dispozitat e mbetura do të qëndrojnë në fuqi dhe IPKO do të gjej me kohë zëvendësim.

10.3 Në rast se ndonjë dispozitë në këto Kushte të Përgjithshme Abonimi bien ndesh me ndonjë dispozitë në Kushtet e Veçanta të Abonimit, të cilat rregullojnë kushtet për shfrytëzimin e shërbimeve specifike, dispozitat në Kushtet e Veçanta të Abonimit do të mbizotërojnë.

10.4 Këto Kushte të Përgjithshme Abonimi janë të publikuara në uebfaqen e IPKO's për favorin e Përdoruesve, ndërsa të njëjtat nuk kanë nevojë të nënshkruhen nga ana e Përdoruesit dhe apo IPKO' s, por që, janë në efekt, nga momenti i nënshkrimit të Kontratës së Abonimit nga ana e Përdoruesit, siç pajtohet dhe në Kontratë.